



Grup Vendor veprimi VJONA

1. Informacion Bazë

- Viti i Themelimit: 2024
- Statusi Ligjor: Grup Vendor Veprimi
- Selia Qendrore: Vlore
- Faqja e Internetit: lagvjona
- Email kryesor i organizatës: lagvjona24@outlook.com
- Telefoni kryesor i organizatës: 00355 69 930 80 90

2. Misioni

Zhvillimi i qëndrueshëm rural në territorin e Bashkisë Vlorë dhe përtej saj, duke promovuar një ekonomi vendore të gjelbër, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Forcimi i kapaciteteve të komuniteteve rurale, përmirësimin e kushteve të jetesës, ruajtjen e burimeve natyrore dhe nxitjen e inovacionit në bujqësi, mjedis dhe turizëm rural përmes bashkëpunimit ndërsektorial dhe pjesëmarrjes aktive të qytetarëve. Nëpërmjet projekteve, trajnimeve dhe ndërveprimit me institucionet publike, organizatat joqeveritare dhe sipërmarrësit ruralë, synon të krijojë një territor të integruar, të fortë ekonomikisht dhe ekologjikisht të qëndrueshëm, duke qenë një urë lidhëse mes qytetarëve dhe politikave zhvillimore lokale e europiane.

2. Vizioni (Opsionale)

Krijimi i një territori të gjallë, inovativ dhe të qëndrueshëm, ku komunitetet lokale janë fuqizuar, ekonomia vendore është e gjelbër dhe konkurruese, dhe mjedisi natyror mbrohet si një pasuri themelore për brezat e sotëm dhe të ardhshëm. Aspiron të bëhet një model referimi për zhvillimin rural të integruar në Shqipëri dhe në rajon, duke nxitur partneritete të qëndrueshme, përfshirje sociale, zhvillim të barabartë dhe qasje novatore në bujqësi, turizëm, kulturë dhe mjedis.

4. Fushat Kryesore të Fokosit

Mbrojtja e Mjedisit

GVV VJONA punon për ruajtjen dhe mbrojtjen e burimeve natyrore, biodiversitetit dhe peizazheve rurale, duke promovuar praktika të qëndrueshme për përdorimin e tokës dhe ujit.

Zhvillimi i Komunitetit

Organizata angazhohet në forcimin e kapaciteteve të komuniteteve rurale përmes përfshirjes qytetare, fuqizimit të grupeve të marginalizuara, dhe zhvillimit të iniciativave sociale dhe ekonomike.

Zbutja e Ndryshimeve Klimatike

GVV VJONA kontribuon në uljen e ndikimit të ndryshimeve klimatike në zonat rurale, përmes promovimit të bujqësisë së qëndrueshme, rryllëzimit, menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe përdorimit të energjisë së rinovueshme.

Advokimi për Politika

Organizata merr pjesë në procese vendimmarrëse lokale dhe kombëtare, duke përfaqësuar interesat e



komuniteteve rurale dhe duke propozuar politika që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm, përfshirjen sociale dhe mbrojtjen e mjedisit.

5. Aktivitetet/Programet Kryesore

Projekti 1: Qendra Multifunksionale për Bujqësinë dhe Klimën në Vlorë

Ky projekt synon të krijojë një HUB rajonal për mbështetjen e fermerëve përmes teknologjive inteligjente (sensorë klimatikë, analiza të të dhënave me AI, trajnime), me qëllim rritjen e rezistencës ndaj ndryshimeve klimatike dhe përmirësimin e prodhimit bujqësor. Përfitues janë fermerët, agronomët dhe institucionet vendore.

Projekti 2: “Zhvillim Rural përmes Ekonomisë Qarkulluese”

Nismë e bashkëfinancuar që ka për qëllim të nxisë përdorimin e mbetjeve organike bujqësore për kompostim dhe rikthim në tokë. GVV VJONA ka organizuar fushata sensibilizuese, trajnime për fermerët dhe bashkëpunim me TV lokal për promovimin e praktikave të gjelbra.

6. Shtrirja Gjeografike

Grupi Vendor i Veprimit “VJONA” përputhet me territorin që shtrihet në kufijtë Administrativ të Bashkisë Vlorë. Në këtë zonë përfshihen 2 Njësitë Administrative të kësaj Bashkie Bashkia e Vlorës kufizohet nga veriu me Bashkinë e Fierit, zona e Apollonisë, në jug me fshatin Kaninë të Njesisë Administrative Qender, në perëndim me derdhjen e lumit Vjose dhe në lindje me territoret e Njesisë Administrative Shushicë. Bashkia Vlorë numëron 204.000 banorë në një territor prej 616.85 km². Njesia Administrative Qender me 18.836 banorë dhe Njesia Administrative Novoselë 17.402 banorë pra zona Leader numëron 36,238 banorë. Bashkia Vlorë përbëhet nga 4 Njësi Administrative: Orikum, Qender, Novoselë dhe Shushicë, 37 fshatra.

Njësitë Administrative	Fshatrat
Qendër	Bestrovë, Babicë e Madhe, Babicë e Vogël, Hoshtim, Kaninë, Kërkovë, Nartë, Sherisht, Panaja, Xhyrinë, Zvernec, Sazan
Novoselë	Novoselë, Aliban, Bishan, Mifol, Poro, Dëllënjë, Delisuf, Trevllazër, Cerkovinë, Skrofotinë, Fitore, Akërnë

7. Udhëheqja

Drejtori Ekzekutiv/CEO: ALMA XHEMA

Bordi i Drejtuesve: AULONA VEIZI, EDISON KAPAJ, ARNOLD BAZAJ, JUSIAN ZANAJ

Anëtarët Themelues të GVV VJONA (Qershor 2024)

- Aulona Veizi - Operator Publik Vendor
- Ornold Bazaj –Operator Ekonomik i Regjistruar (Sektor Privat)
- Edison Kapaj –Operator Ekonomik i Regjistruar (Sektor Privat)
- Jusian Zanaj –Fermer i Regjistruar (Sektor Privat)
- Marika Lena – Fermer i Regjistruar (Sektor Privat)
- Vojsava Harunaj – Fermer i Regjistruar (Sektor Privat)
- Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor “BIOVAJ TREVLLAZËR” – përfaqësuar nga z. Taulant Myrtaj (Kooperativë e Sektorit Privat)



- h) Njësia Administrative Novoselë, Bashkia Vlorë – përfaqësuar nga z. Arben Hyso (Operator Publik Vendor)

8. Partneritetet dhe Bashkëpunimet (Opsionale)

Institucione publike si:

- ✓ Njësiti Administrativ Qendër dhe Novoselë
- ✓ AREB (Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor)
- ✓ ADZM Vlorë (Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura)

Organizata të shoqërisë civile dhe mjedisore:

- ✓ PPNEA (Partnerët Shqipëtarë për Mbrojtjen e Mjedisit)
- ✓ Shoqata “Laguna e Nartës”, Shoqata “Adriatik”, Shoqata “Kristo Papajani”, Shoqata e Gjuetarëve dhe Shoqata e Peshkatarëve lokalë

Organizata partnere ndërkombëtare dhe donatorë, si:

- ✓ GIZ –përmes programit rajonal “Mbështetje për diversifikimin ekonomik të zonave rurale në Evropën Juglindore (SEDRA)”
- ✓ ANRD (Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural) – mbështetës në procesin e hartimit të strategjisë dhe fuqizimit të rrjeteve vendore

Aktorë të sektorit privat dhe ekonomik lokal, përfshirë:

- ✓ Fermerë dhe kooperativa si BIOVAJ TREVLLAZËR
- ✓ Fabrika përpunimi, kantina vere, pika grumbullimi dhe subjekte të turizmit rural
- ✓ Sektorë edukativë dhe kërkimorë, përfshirë institucione arsimore, guida turistike dhe ecomuseume të zonës.

9. Ndikimi (Opsionale)

- ✓ 200+ aktorë lokalë të përfshirë në procesin e mobilizimit komunitar, duke përfshirë fermerë, gra, të rinj, institucione publike dhe organizata të shoqërisë civile.
- ✓ 5 seanca trajnimi për komunitetin dhe 4 takime konsultuese me palët e interesuara për hartimin e strategjisë së zhvillimit vendor.
- ✓ Strategji Zhvillimi Vendor 2024–2030 e hartuar me pjesëmarrje të gjerë, në përputhje me metodologjinë LEADER dhe udhëzimet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
- ✓ 14 anëtarë të bordit të zgjedhur në mënyrë gjithëpërfshirëse, përfaqësues të sektorit publik, privat dhe të shoqërisë civile.
- ✓ 36,238 banorë të zonës “Leader” potencialisht përfitues nga programet dhe ndërhyrjet e GVV VJONA.
- ✓ 3 partneritete rajonale të vendosura me organizata kombëtare dhe ndërkombëtare (ANRD, GIZ SEDRA, PPNEA) për zbatimin e programeve zhvillimore.
- ✓ 2 Njësi Administrative (Qendër dhe Novoselë) të mbuluara nga strategjia, me synim përfshirjen e të gjithë fshatrave në politikat vendore të zhvillimit të qëndrueshëm.

10. Lajmet e Fundit/Çmimet (Opsionale)